

MENDIM PARALEL

1. Lidhur me vendimin nr. 367, datë 16.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, parashtroj sa më poshtë argumentet e një arsyetimi paralel, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Maksuti, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Pavarësisht, votimit për shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Maksuti, kam ndarë mendim paralel/ndryshe nga arsyetimi i vendimit të Komisionit, në lidhje me pasurinë apartament, të ndodhur në rrugën “D.B”, Tiranë, në pronësi të babait, pasi referuar dokumentacionin të administruar në dosje, apartamenti është blerë nga babai në vitin 2004, me burim kryesisht të ardhurat nga puna e tij, si noter dhe avokat, vite përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit (i emëruar në vitin 2008), si dhe me të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve të tjerë, të ndodhur në Peshkopi dhe Tiranë.
3. Sipas pikës 33.5 të këtij vendimi, analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit në lidhje me këtë apartament, pas kalimit të barrës së provës ka rezultuar me një pamjaftueshmëri financiare në shumën **3,237,925** lekë.
4. Në situatën objekt vlerësimi, do i jepja rëndësi fakteve objektive dhe ligjore, që janë të lidhura me:
 - a) faktin se Subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e prokurorit, pas 3 vjetësh nga momenti i blerjes së pasurisë apartament në vitin 2004, nga babai i tij.
 - b) faktin se në kohën kur janë përfituar këto të ardhura, babai i subjektit nuk gëzonte statusin e personit të lidhur të një subjekti rivlerësimi, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.
 - c) faktin se pasuria apartament në pronësi të babait, është blerë në vitin 2004 kryesisht me të ardhurat e tij, të fituara gjatë një periudhe të hershme në kohë, (nga viti 1992 e ne vijim, kur subjekti ishte fëmijë i mitur 15 vjeçar) dhe rrethana familjare që i ndjeri babai i subjektit nuk jeton,

e vendos subjektin e rivlerësimit në pamundësi objektive për të provuar plotësisht burimet e ligjshme, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të deklaruar saktë dhe për të provuar plotësisht burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie në përputhje me germen “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit 84/2016.

Përfundimisht, ndryshe nga sa ka konkluduar shumica e trupit gjykues, në pikat 33.6 dhe 33.7 të vendimit, konkludoj se pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të prindërve për blerjen e kësaj pasurie, nuk duhet të ngarkoj me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit, për shkak se krijimi i të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit nga babai, i takojnë një periudhe të hershme, përpara se subjekti të merrte detyrën e prokurorit.

ANËTARI I TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU / mendim paralel